KËRKESË
Nr. 5008/3, datë 17.9.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i zonës fundore të sheshit 'Santa Barbara' dhe ndërtimi i godinës së Bashkisë Divjakë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Divjakë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Për pasuritë e llojit "ndërtesë" dhe "banesë", në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen", të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Divjakë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4 263 424.81 (katër milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e katër pikë tetëdhjetë e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

TABELA E VLERËSIMIT PARAPRAK PËR PASURITË PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I ZONËS FUNDORE TË SHESHIT 'SANTA BARBARA' DHE NDËRTIMI I GODINËS SË BASHKISË DIVJAKË"

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit m^2	Sip. e prekur e truallit në m^2	Çmimi për truall (lek/m^2)	Vlera e truallit	Sipërfaqja e ndërtimit në kartelë	Sip. e ndërtesës, sipas faktit (m^2)		Sip. e prekur e ndërtesës (m^2)	Sipërfaqja totale e ndërtesës që shpronësohet (m^2)	Vlera e ndërtesës (lek)	Vlera e përgjith. truall + ndërtesë (lek)	Gjendja juridike	Statusi juridik
									Kat shërbimi (m^2)							
									Kati përdhes (m^2)	Kati I (m^2)						
1	**Filip Gorreja, Natasha Gorreja**	1492	630/83	190	190	514	**97,660.0**	173	145	0	145	145	**2,504,646.52**	**2,602,306.52**	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
2	**Filip Gorreja, Natasha Gorreja**	1492	630/98	310	310	514	**159,340.0**	0	0	0	0	0	**-**	**159,340.00**	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
3	**Nerenxe Mehmeti**	1492	630/88	120	120	514	**61,680.0**	120	107	0	107	107	**910,158.08**	**971,838.08**	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
4	**Prokop Vodo**	1492	630/78	60	60	514	**30,840.0**	42	42	0	42	42	**499,100.21**	**529,940.21**	Konfirmim nga ASHK-ja.	Nuk ka shënime.
VLERA PARAPRAKE														**4,263,424.81**		